

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6269  
E shtunë, 20 mars 2021  
çmimi 0.40 €

KOMITETI KUNDËR COVIDIT NUK KA VENDOSUR PËR MASA TË REJA KUFIZUESE FAQE 4-5

## SPITALET NUK DO TË MUND TA PËRBALLOJNË FLUKSIN E PACIENTËVE ME COVID



Kosova ka regjistruar të premten numrin më të lartë të infektiveve me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë raportuar tetë të

vdekur, 828 raste të reja të të infektuarve dhe 744 të të shëruarve nga Covid-19. Pavarësisht prej këtyre shifrave, Komiteti kundër Covidit nuk ka vendosur për ndryshim të masave.

Drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK), Valbon Krasniqi, ka thënë se shumë shpejt spitalet e Kosovës nuk do të mund ta përballojnë fluksin e pacientëve me Covid-19

KRYETARI I LIDHJES DEMOKRATIKE I KOSOVËS (LDK), LUMIR ABDIXHIKU, është takuar me Kryetarin e Lëvizjes VETËVENDOSJE, ALBIN KURTI DHE KANDIDATEN PËR PRESIDENTE, VJOSA OSMANI FAQE 7

## ABDIXHIKU PARALAJMËRON TAKIM TË RI PËR KANDIDATURËN E OSMANIT PËR PRESIDENTE



Kryetari i ri i Lidhjes Demokratike i Kosovës (LDK), Lumir Abdixiku, ka thënë se, pas formimit të institucioneve të Kosovës, kjo parti do të takohet me Vjosa Osmanin, pretendente për president, për t'i parë qëndrimet e saj karshi partive opozitare, në veçantë për nismën e saj të paralajmëruar

**RENOVA**  
PUTZ  
Makedoni Xheqisht-Tetovë Curë-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: renova@mt.net.mk

**PRINCESHA**  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)


**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



FAQE 3



## OPINION

A TË BËN MË TË LUMTUR MIGRIMI? F. 11

Nga Mimoza KELMENDI



## AKTUALE



RIHAPET RASTI LIDHUR ME VRASJEN E AGONIS TETAJT F. 8

CJENERAL RRAHMAN RAMA MERR PËRKRAHJEN E ITALISË PËR FSK-në F. 7



## EKONOMI

NITAJ KËRKON PEZULLIMIN E PËRZGJEDHJES SË KRYESHEFIT TË POSTËS F. 9

KEDS-i INVESTON NË ZONËN TURISTIKE TË BREZOVICËS F. 9



## SPORT

SHORT I PAMËSHIRSHËM, BAYERN - PSG-SË, REAL - LIVERPOOL F. 12



**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.  
DEGA KOSOVO  
Ruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**  
Digital Agency  
Internet Website, Marketing...

## Vendet e BE-së do të rinisin imunizimin me "AstraZeneca"

**BRUKSEL, 19 MARS** - Shtetet kryesore të Bashkimit Evropian do ta rinisin imunizimin kundër koronavirusit me vaksinën "AstraZeneca", pasi rregulatori shëndetësor i BE-së konfirmoi se ajo është "e sigurt dhe efektive".

Agjencia Evropiane e Barnave e rishikoi vaksinën pasi 13 shtete të BE-së e pezulluan përdorimin e saj nga frika se shkakton mpiksje gjaku.

Agjencia konstatoi se vaksina nuk lidhet me ndonjë rrezik më të lartë të mpiksjes së gjakut.

Gjermania, Franca, Italia dhe Spanja thanë se do ta rinisin përdorimin e vaksinës.

U takon shteteve individuale të BE-së që të vendosin nëse duan dhe kur duan të rinisin imunizimin me "AstraZeneca".

Suedia tha se i duhen "disa

ditë" për të vendosur. Organizata Botërore e Shëndetësisë u bëri thirrje vendeve që ta vazhdojnë përdorimin e vaksinës, ndërsa sot pritet t'i publikojë rezultatet e saj të rishikimit të vaksinës.

Cfarë ka ndodhur me vaksinën "AstraZeneca"?

Danimarka është bërë javën e kaluar vendi i parë që ka ndaluar përdorimin e vaksinës "AstraZeneca", pas raporteve për mpiksje gjaku te disa njerëz.

Një person, madje, ka vdekur si pasojë e trombozave të shumta, dhjetë ditë pasi është vaksinuar me dozën e parë të "AstraZenecës".

Autoritetet shëndetësore daneze kanë thënë se pezullimi do të zgjasë së paku dy javë,



derisa rastet të hetohen. Megjithatë, ato kanë theksuar se "aktualisht nuk mund të konstatohet nëse ekziston ndonjë lidhje midis vaksinës dhe mpiksjes së gjakut". Shpejt pas Holandës, edhe

vendet e tjera të BE-së, por jo vetëm, kanë pezulluar imunizimin me "AstraZeneca". Kompania "AstraZeneca", që ka zhvilluar vaksinën në bashkëpunim me Universitetin e Oksfordit, ka thënë se më pak se 40 raste të mpiksjes së gjakut janë raportuar që nga java e kaluar, ndërsa janë vaksinuar miliona njerëz.

"AstraZeneca" ka thënë më herët se siguria e ilaqit është studiuar gjérësish gjatë provave klinike.

## Qeveria afgane dhe talibanët pajtohen për t'i përshpejtuar bisedimet për paqe

**MOSKË, 19 MARS** - Një zyrtar i lartë afgan ka thënë se Qeveria e Afganistanit dhe talibanët janë pajtuar në Moskë që të tentojnë t'i përshpejtojnë bisedimet, me qëllim të përfundimit të disa dekadave të luftës në këtë shtet.

Takimi i 19 marsit ka ardhur pas konferencës ndërkombëtare që është zhvilluar në kryeqytetin e Rusisë një ditë më parë, për procesin e paqes afgane, dhe vetëm gjashtë javë para afatit të fundit për Shtetet e Bashkuara që t'i tërheqin trupat ushtarake. Konferenca ka pasur qëllim t'i jetësojë negociatat që kanë nisur në shtator të vitit të kaluar



në mes të qeverisë afgane dhe talibanëve, të cilat janë ndalur pas akuzave të qeverisë, se kryengritësit kanë bërë shumë pak për ta ndalur dhunën.

Abdullah Abdullah, udhëheqës i Këshillit Kombëtar të Afganistanit për Pajtim, i ka thënë agjencisë ruse të lajmeve RIA, se palët nuk kanë

diskutuar ndonjë çështje specifike kur janë takuar më 19 mars. Mirëpo ai ka thënë se ekipi i qeverisë afgane ka shprehur "gatishmëri për ta përshpejtar procesin e paqes" dhe se talibanët janë deklaruar njëjtë.

Ai ka paralajmëruar se nëse nuk shfrytëzohet kjo mundësi për paqe, asnjëra palë nuk do të përfitojë. Në një deklaratë të përbashkët të lëshuar nga Departamenti amerikan i Shtetit, pas bisedimeve të 18 marsit, Shtetet e Bashkuara, Rusia, Kina dhe Pakistani u kanë bërë thirrje palëve të përfshira në konflikt "që t'i nisin

menjëherë diskutimet për çështjet thelbësore për zgjidhje të konfliktit".

Në mesin e këtyre çështjeve përfshihen "krijimi i një të ardhmeje paqësore dhe shtet stabil afgan, krijimi i një rrugë politike që çon në qeveri gjithëpërfshirëse dhe modalitetet për armëpushim të përhershëm".

Takimi i Moskës ka qenë një prej tre konferencave ndërkombëtare që janë planifikuar të mbahen para afatit të fundit të 1 majit, për tërheqjen e trupave amerikane dhe të atyre të NATO-s nga Afganistani.


## Amerika paralajmëron Gjermaninë: Braktisni menjëherë projektin e gazsjellësit rus

**WASHINGTON, 19 MARS** - Departamenti amerikan i shtetit u ka bërë hapur thirrje kompanive të reshtin aktivitetin mbi gazsjellësin polemizues Nord Stream 2, në të kundërt rrezikojnë të përballen me sanksione.

ShBA-ja e cilësoi projektin si një plan i Rúsisë "për ta përcarë Evropën dhe dobësuar sigurinë energjetike evropiane". "Administrata Biden e ka bërë të qartë se 'Nord Stream 2' është një marrëveshje e keqe. Ne do të vazhdojmë ta monitorojmë aktivitetin dhe të paralajmërojmë çdo entitet të

përfshirë te Nord Stream 2 se do të rrezikojë sanksione. Jemi të përkushtuar që për këtë çështje të jemi në një linjë me legjislacionin e Kongresit", ka deklaruar sekretari amerikan i shtetit, Anthony Blinken.

Ai ka theksuar se disa administrata amerikane e kanë bërë të quartë se gazsjellësi rus është një projekt gjeopolitik, që synon ta mbjellë farën e përçarjes në kontinentin e jetër. Shtetet e Bashkuara janë përpjekur në mënyrë aktive t'i bindin aleatët evropianë që ta blejnë gazin natyror amerikan në vend të atij rus.



PRESIDENTI I SERBISË, ALEKSANDËR VUÇIQ, KA NXITUR REAGIME TË SHUMTA ME NJË FOTOGRAFI TË PUBLIKUAR NË RRJETIN SOCIAL “INSTAGRAM”, NË TË CILËN SHIHET FLAMURI I SERBISË MBI HARTËN E KOSOVËS

# Kosova dënon provokimin e Vuçiqit

Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë dënuar veprimin e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili ka postuar në rrjetin social "Instagram" flamurin e Serbisë mbi hartën e Kosovës. Ata kanë vlerësuar se ky është një provokim i radhës i presidentit serb. Ndërsa Bashkimi Evropian ka bërë thirrje për përbajtje nga deklaratat që dëmtojnë normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi

**EPOKA  
E RE**

Muhamed KOCL

**PRISHTINË, 19 MARS** - Skena politike në Kosovë ka reaguar ndaj veprimit të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili ka postuar në rrjetin social "Instagram" flamurin e Serbisë mbi hartën e Kosovës. Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovën kanë dënuar këtë gjest të presidentit serb duke e vlerësuar provokues. Sipas tyre, Serbia vazhdimisht e ka bërë një gjë të tillë, pavarësisht prej zotimeve para partnerëve ndërkombëtarë.


Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka dekluaruar se kjo tregon destruktivitetin e Serbisë ndaj Kosovës. “Deklarata e Presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tregon qasjen destruktive që ka pasur në vazhdimësi fqinji ynë verior në raport me Republikën e Kosovës, përkundër zotimeve të shumta që Serbia i ka bërë, nën para faktorit ndërkombëtar, për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit. Me gjithë provokimet që vijnë nga fqinji ynë verior, Republika e Kosovës, përmes angazhimit dhe vendosmërisë, sigurt po vazhdon rrugëtimin drejt anëtarësimit sa më të shpejtë në NATO, Bashkim Evropian dhe në të gjitha institucionet relevante ndërkombëtare”, ka shkruar Hoti në profilin e vet në “Facebook”

Kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë se në këtë mënyrë Serbia po nxit propagandë urrejtje ndaj fqinjëve të saj. "Serbia nën Aleksandër Vuçiqin, sundimi autokratik është në një gjendje hipnoze, ku propaganda dhe urrejtja nxiten kundër fqinjëve. Kosova si një shtet i pavarur dhe sovran është muri i vlerave euroatlantike kundër mentalitetit të moshës së mesme", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e tij në "Twitter". Kurse ish-kryenegociatorja për

bisedime teknike në dialogun Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka thënë se presidenti serb po e tregon mendimin e tij hegemonik. "Serbia e Vuçiqit ka dalë me provokime të reja kundër Kosovës, duke treguar mendimin e tij hegemonik. Njëherë në dialogun në Bruksel kundërshtoi ai provokoi në mënyrë të ngjashme, unë iu përgjigja duke i thënë, 'duket se të mungojnë bombardimet e NATO-s'. Po i thotë, 'Kam them sérish!', ka shkruar Tahiri. Edhe ministri i Shtetit për Diasporën në Shqipëri, Pandeli Majko, e ka dënuar veprimin e presidentit serb. Ai ka reaguar ashpër ndaj presidentit serb Aleksandër Vuçiq, pasi ky i fundit publikoi një fotografi ku shihet harta e Kosovës e mbuluar me flamurin serb. "Me publikimin e fotos së Republikës së Kosovës me flamurin serb, presidenti i Serbisë, Vuçiq, tregon se i pëlqen papajtueshmëria. Ky është një problem i shtetit serb, dhe i seriozitetit të zgjedhur në Beograd. Republika e Serbisë nënshkroi një deklaratë në zyrën ovale të Shtëpisë së Bardhë për ta respektuar procesin e paqes rajonale. Diplomacia e fotove në 'Instagram' zhvlerëson seriozitetin e shtetit serb në marrëdhëniet ndërkombëtare", ka shkruar Majko në llogarinë e vet në "Facebook".

BE-ja bën thirrje për përbajtje nga deklaratat që dëmtojnë normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi


Bashkimi Evropian ka përsëritur të premtën thirrjet për liderët politikë, në Kosovë dhe Serbi, që të përbahen nga veprimeet dhe deklaratat të cilat shkojnë në kundërshtim me normalizimin e raporteve mes tyre. "Bashkimi Evropian i ka ftuar gjithmonë të gjithë aktorët politikë në Serbi dhe Kosovë, sikur edhe në pjesë të tira, të raionit që të



[View More on Instagram](#)

**Ish-presidenti Nishani: Tirana duhet të reagojë ndaj provokimit të Vuciqit që i bëri Kosovës**

Edhe ish-presidenti i Shqipërisë, Bujar Nishani, ka reaguar ndaj veprimit të presidentit serb Aleksandër Vuçiq. Në një shkrim në "Facebook", ai ka thënë se provokimi i Vuçiqit mbi Republikën e Kosovës është një provokim dhe kërcënim mbi sigurinë dhe stabilitetin e të gjithë rajonit. "Nuk është aspak e largët koha kur Serbia për hegemoni nisi luftëra të përgjakshme në rajonin e Ballkanit, kundër Sllovenisë, kundër Kroacisë, kundër Bosnje-Hercegovinës e kundër Kosovës. Luftërat e nisura nga Serbia i shkaktuan këtij rajoni mijëra viktima, gjenocid, shkatërrime masive dhe eksod të popujve drejt Evropës", ka shkruar ai. Sipas tij, tentativa e provokime të njëjtë përsëri janë një "ogur" i keq për paqen dhe stabilitetin në kufijtë evropianë. Nishani shprehet se megjithëse ky një kërcënim e provokim i hapur nuk pati asnjë reagim apo denoncim nga Tirana zyrtare. "Turp! E paçin faqen e zezë! Nuk mund të presësh gjë tjetër prej argatëve të Beogradit në Tiranë, veç heshtjes", ka shkruar Nishani.



KOMITETI KUNDËR COVIDIT NUK KA VENDOSUR PËR MASA TË REJA KUFIZUESE

# Spitalet nuk do të mund ta përballojnë fluksin e pacientëve me Covid

Kosova ka regjistruar të premtën numrin më të lartë të infektiveve me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë raportuar tetë të vdekur, 828 raste të reja të infektuarve dhe 744 të shëruarve nga Covid-19. Pavarësisht prej këtyre shifrave, Komiteti kundër Covidit nuk ka vendosur për ndryshim të masave. Drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK), Valbon Krasniqi, ka thënë se shumë shpejt spitalet e Kosovës nuk do të mund ta përballojnë fluksin e pacientëve me Covid-19

**EPOKA ERE** Muhamet KOçi  
PRISHTINË, 19 MARS - Komiteti për pandeminë Covid-19 nuk ka marrë asnjë vendim përmes tij të reja kufizuese pavarësisht se tij të premtën Kosova ka shënuar numrin më të madh të infektuarve me Covid. Anëtarët e këtij komiteti kanë pranuar që në javët e fundit gjendja me Covid është përkeqësuar, por nuk e kanë parë të arsyeshme tjetër marrin vendim përmes një masë kufizuese.

Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka folur përmes një analizë së sigurimin sa më shpejt të vaksinës. "Angazhimi përmarrjen e vaksinës është angazhim ditor, ka vështirësi

rriten rastet, mbështetet brenda muajit mars do të tejkalojen kapacitetet. I bëjmë thirrje edhe komitetit dhe qeverisë që tij na shtojnë kapacitetet", ka thënë Krasniqi. Sipas tij, në spitalet e përgjithshme rajonale dhe në klinikat Covid të QKUK-së janë duke u trajtuar 798 pacientë të prekur me koronavirus.

Kurse drejtori i IKShPK-së, Naser Ramadani, ka thënë në këtë mbledhje se numri i rasteve pozitive me koronavirus është rritur përmes 27.6 pind në krahasim me dy javët paraprake. "Në javët e fundit ka pasur rritje të rasteve prej 27.6-përqindësh, përfshirë edhe tjetra dhënat e sotme. 619 raste mesatare në ditë

## Zemaj: Angazhimi përmarrjen e vaksinës është ditor

Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, në mbledhjen e komitetit për pandeminë, ka folur edhe përvaksinat. Ai ka treguar se sasia e vaksinave përmes Kosovës, sipas programit të COVAX-it, ka nisur prodhimin gjatë muajit mars. Ai ka thënë se komunikimi është i rregullt me partnerët ndërkombëtarë përsigurimin sa më shpejt të vaksinës. "Angazhimi përmarrjen e vaksinës është angazhim ditor, ka vështirësi

në furnizimin me vaksina. Të gjitha premtimet që kemi pasur nga prodhuesit jemi duke i negociuar. Janë në procedurë. Covax sasinë e prodhimit të vaksinave përmes Kosovës ka nisur gjatë marsit. Kemi bërë përgatitjet. Gjithçka është konform standardeve dhe rregullave. Nuk ka adresë ndërkombëtare dhe tjetër partnerëve sepse komunikimi është i rregullt me shtetet më të BE-së, KE-në, ShBA-në, Japoninë", ka deklaruar Zemaj.

krahasuar me dy javët e kaluara. Numri mesatar ka qenë 548 raste. Gjatë këtyre dy javëve kemi regjistruar 110 raste të vdekurve apo me një mesatare prej tetë të vdekur në ditë. Ka një rritje prej 40-përqindësh krahasuar me dy javët e kaluara", ka thënë Ramadani duke folur për rritje të rasteve. "Duke përshkruar një rritje të numrit të rasteve, në mesataren 619 raste në ditë, në 24 orët e fundit janë testuar mbi 5 000 mostra që kanë rezultuar 828 pozitive", ka thënë Ramadani. Ndërsa zëvendësministri në detyrë i Arsimit, Xhavit Rexhaj, ka thënë se shkalla e infektimeve me Covid-19 nuk ulet edhe po të mbylljet i tërë sistemi arsimor. "Kohët e fundit është vërejtur ngritje e shkalleve të infektimit dhe, po ashtu, në kuadër të këtij vlerësimi kemi pasur kërkesë nga IKShPK-ja të lejohet dy javë pushim në shkolla. Ministria ka mbledhur menaxhmentin e vet dhe kemi dalë me propozim 1+1, nxënësit të shkojnë në pushim njëjavor, pra 9 ditë dhe në fund të asaj jave të bëhet një vlerësim dhe të vendoset nga të gjitha palët se si të shkohet më tutje", ka thënë Rexhaj.

## Tetë viktima dhe 828 raste të të infektuarve me koronavirus

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka regjistruar të premten tetë viktima me koronavirus. IKShPK-ja ka njoftuar se mosha e tetë personave që kanë ndërruar jetë nga Covid-19 në 24 orët e fundit sillet nga 64 deri në 84 vjeç. "Rastet e të vdekurve janë nga komunitat: Prishtinë 2 raste (64, 77 vjeç), Fushë-Kosovë 1 rast (77 vjeç), Gjakovë 1 rast (64 vjeç), Obiliq 1 rast (84 vjeç), Rahovec 1 rast (72 vjeç), Shtime 1 rast (68 vjeç), Viti 1 rast (69 vjeç)", është thënë në njoftim. Në 24 orët e fundit janë identifikuar 828 raste të infektimit me këtë virus, pas

testimit të 5 102 mostrave në institucionet publike dhe ato private.

Më 19 mars sëmundjen Covid-19 e kanë mposhtur 744 persona, derisa aktive janë 11 812 raste.

Prej regjistrimit të rasteve të para me koronavirus në Kosovë, më 13 mars të vitit të kaluar, autoritetet shëndetësore kanë regjistruar 80 621 raste të infektimit. Prej tyre, 1 744 kanë vdekur.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK), pas konfirmimit të 828 rasteve të reja me Covid-19, ka bërë apel për respektimin e masave kundër Covid-19.

"IKShPK-ja u bën thirrje të gjithë qytetarëve, institucioneve dhe organizatave publike dhe private, për respektimin dhe ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për parandalimin, menaxhimin dhe kontrollin e infeksionit Covid-19, duke marrë parasysh dispozitat e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, dhe vendimet në fuqi mbi masat dhe obligimet e institucioneve për zbatimin e masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19", është thënë në apelin e IKShPK-së.

## Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës do të financojë Kosovën për blerje të vaksinave

Prishtinë, 19 mars - Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës (CEB) ka miratuar dhënien e huas shtesë prej 25 milionë eurove për t'i mbështetur autoritetet e Kosovës për blerjen e vaksinave kundër koronavirusit, për gati 50 për qind të popullsisë. Kjo hua do ta mbulojë edhe koston për materialet shpenzuese, bashkë me harxhimet lidhur me shpërndarjen e vaksinave dhe pajisjeve mjekësore.

Kosova pritet t'i përfitojë vaksinat e para nga Covax - skema e Organizatës Botërore e Shëndetësisë për shpërndarje të vaksinave në vendet e varfara.

Me këtë hua të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, Kosova besohet se do të mund të blejë vaksina për 50 për qind të popullsisë.

Guvernatori i kësaj banke, Rolf Wenzel, ka thënë se Banka për Zhvillim është e lumtur që do të mund ta ndihmojë Kosovën në përgjigjen e saj ndaj pandemisë, si dhe ta adresojë qasjen jo të barabartë në vaksina. "Kjo gjë nuk është thelbësore vetëm për ta



tejkaluar krizën aktuale me pandeminë, por edhe për t'i zbutur pabarazitë sociale dhe ato ekonomike në rritje si pasojë e pandemisë".

Kjo hua sigurohet pas një marrëveshjeje prej 35 milionë

eurosh, të nënshkruar në gusht të vitit 2020 në mes të autoritetetve të Kosovës dhe Bankës për Zhvillim, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të nxitura nga pandemia.

Kosova vazhdon të mbetet vendi i vetëm në Evropë që nuk ka nisur procesin e vaksinimit. Në dërgesën përmes Covax-it, Kosova do të përfitojë 100 800 doza të vaksinës së prodhuar nga kompania "AstraZeneca".

Ministria e Shëndetësisë në Kosovë, në fillim të muajit janar, pati njoftuar se ka marrë konfirmim nga kompania amerikane "Pfizer" për sigurimin e 535 000 vaksinave kundër koronavirusit.

## Zyra për Barazi Gjinore jep mirënjojje për gratë që kanë kontribuar ndër vite në Malishevë

**MALISHEVË, 19 MARS (ER)** - Organizuar nga zyrtarja e Zyrës për Barazi Gjinore (ZBG) në Komunën e Malishevës, Vera Bytyçi, të premtën, me rastin e festave të marsit, është mbajtur takim, në të cilin janë dhënë mirënjojje për gratë të kontributdhënëse ndër vite, në disa sfera të jetës, duke përfshirë kontributin në luftë, në arsim, në shëndetësi, biznes dhe në organizatat joqeveritare që merren me avancimin e gruas në Malishevë.

Fillimisht, Zyrtarja për Barazi Gjinore bëri një prezantim të punës së zyrës që drejtton, si dhe foli për gratë të cilat kanë punuar dhe janë angazhuar ndër vite, me qëllim të avancimit të gruas në shoqëri. Zyrtarja Bytyçi ka falënderuar edhe kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe gratë asambliste për

përkrahjen e vazhdueshme në aktivitetet e ZBG-së, si dhe të organizimeve të tjera dhe përkrahjen për aktivitetet e organizatave të grave.

Zyra për Barazi Gjinore ka dhënë mirënjojje për gratë të cilat kanë kontribuar ndër vite në shoqëri, duke filluar nga familia e dëshmorit të kombit Imer Krasniqi, pastaj veteranët luftëtarë të UÇK-së, Hava Zogaj, përfaqësuesen e OJQ "Femrat e Llapushës", Zade Zogaj, për kontribut në shëndetësi është dhënë mirënjojje për Sadije Thaçin, për kontribut në arsim për profesoreshën Bukurije Mazreku dhe mësuesen Sahadete Hoxha-Gashi, në fushën e biznesit për Zoja Telakun, si dhe mirënjojje është dhënë edhe për Sabile Doli, ish-drejtoreshë e strehimores "Shtëpia e sigurt".



## Shpërndahen pajisje të punës për ndërmarrësit llapjanë

**PODUJEVË, 19 MARS (ER)** - Në kuadër të projektit "Mbështetje stabilitet socio-ekonomik në Kosovë", i financuar nga organizata gjermane "Help" dhe Komuna e Podujevës, janë përkrahur me pajisje pune për veprimtari të ndryshme biznesi ndërmarrës llapjanë.

Drejtori i Drejtorisë i Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Pajtim Balaj, bashkë me përfaqësues të kësaj organizate, kanë bërë shpërndarjen e pajisjeve të

punës për përfituesit e këtij projekti.

Qëllimi i këtij projekti është krijimi i kushteve më të mira për ndërmarrësit "start up", për mikrobizneset dhe për ngritjen e kapaciteteve të tyre në sferën ekonomike.

Drejtori Balaj ka falënderuar përfaqësuesit e organizatës "Help", duke shprehur gatishmërinë përbashkëpuni edhe në të ardhmen, për përkrahjen dhe mbështetjen e bizneseve llapjane.

## Gjilani shënon Ditën Ndërkombëtare të Personave me Sindromën Down

**GJILAN, 19 MARS (ER)** - Komuna e Gjilanit, bashkë me Qendrën e Kujdesit Ditor "Pema", kanë mbjellë 21 fidanë në lagjen "Iliria" në shënim të 21 marsit, Ditës Ndërkombëtare të Personave me Sindromën Down.

Selami Xhemiali, drejtor i Shëndetësisë, ka thënë se Komuna e Gjilanit me të gjitha kapacitetet buxhetore e kanë mbështetur qendrén "Pema" dhe të gjitha organizatat që përkujdesen për trajtimin e personave me Sindromën Down. "Ne si komunë e kemi shprehur gatishmërinë që iniciativën e qendrës 'Pema' ta

përkrahim në institucionet komunale, gjegjësisht Kuvendin Komunal, për emërtimin si 'Parku i 21 fidanëve' që është simbolikë e shënimit të 21 marsit, në shenjë solidarizimi me fëmijët me Sindromën Down, në mënyrë që Gjilani ka këtë një hapësirë që iu dedikohet atyre", ka thënë Xhemiali.

Përfaqësuesja e Qendrës së Kujdesit Ditor "Pema", Emine Sallahu, ka thënë se i kanë propozuar Komunës së Gjilanit mbjelljen e 21 fidanëve, duke shfaqur shpresën që ky park të quhet parku i 21 fidanëve.



Kryetari i Lidhjes Demokratike i Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, është takuar me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe me kandidaten për president, Vjosa Osmani

## Abdixhiku paralajmëron takim të ri për kandidaturën e Osmanit për president

Kryetari i ri i Lidhjes Demokratike i Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se pas formimit të institucioneve të Kosovës kjo parti do të takohet me Vjosa Osmanin pretendente për president, për t'i parë qëndrimet e saj karshi partive opozitare, në veçanti për nismën e saj të paralajmëruar

**EPOKA ERE** **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 19 MARS** - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, është takuar të premten me liderin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe kandidaten për president, Vjosa Osmani, me të cilët ka folur për formimin e institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet e 14 shkurtit. "Ne sot përfunduan takimin e parë me përfaqësuesin dhe kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, diskutuan për formimin e institucioneve. Kemi përfunduar takimet me LV-në sepse pozicionet tona janë të qarta. LV-ja është në pozitë. Ne

në opozitë do të jemi aktive dhe alternative e re. Këtu përfundojmë takimin. Jemi pajtuar që pas formimit të qeverisë të takohemi me pretendenten për president dhe të kuptojmë më quartë pozicionin e saj karshi LDK-së dhe LV-së", ka thënë Abdixhiku.

Ai ka thënë se LDK-ja do të marrë pjesë në seancën e së hënës kur pritet të konstituohet legislatura e re e Kuvendit të Kosovës, mirëpo nuk ka dhënë më shumë hollësi për seancat e tjera. Abdixhiku ka njoftuar se sot (e shtunë) do të formohet kryesia e re e LDK-së dhe do të shpalosen detajet e takimit me Kurtin dhe Osmanin.

Në fund ai ka shtuar se nuk



janë të interesuar të shkaktojnë destabilizim politik.

Lideri i LV-së, kandidat për kryeministër, Albin Kurti, është takuar këto ditë edhe me kryetarin e PDK-së, Enver Hoxhaj, kryetarin e AAK-së, Ramush Haradinaj dhe përfaqësuesit e komuniteteve në vendin tonë.

Për dallim nga Abdixhiku,

ushtuesi i detyrës i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka qenë të enjen më i drejtë përdrejtë sa i përket kandidaturës së Osmanit për president. Ai e ka quajtur Osmanin figurë përcarëse dhe ka thënë se PDK-ja nuk ka votë për të. Po të enjen, kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se

partia që drejton ai do të jetë pjesë e konstituimit të Kuvendit të Kosovës. Për secilën seancë tjetër, Haradinaj ka thënë se grupi parlamentar i AAK-së do të diskutojë veç e veç. Ditë më parë Haradinaj ka thënë se është përgjegjësi e Lëvizjes Vetëvendosje që t'i sigurojë votat e nevojshme në kuvendin e ri për zgjedhjen e presidentit të Kosovës.

## Gjeneral Rrahman Rama merr përkrahjen e Italisë për FSK-në

**PRISHTINË, 19 MARS (ER)** - Me ftesë zyrtare të homologut të tij, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënan Rrahman Rama, ishte në vizitë zyrtare katërditore në Republikën e Italisë. Me këtë rast, me nderimet më të larta ushtarake ai u priti nga autoritetet më të larta ushtarake italiane.

Në takimet përkatëse u diskutua për format e implementimit të planit të vepimit në kuadër të bashkëpunimit bilateral në mes të dy forcate. Nga ana e tij, gjeneral Rama ka shprehur mirënjojohjen dhe vlerësimin e



lartë të shtetit dhe forcave italiane për rolin e tyre të madh

në kuadër të misionit të KFOR-it në përgjithësi si dhe për

kontributin e madh për ndërtimin, zhvillimin dhe të arriturat e deritashme të FSK-së në veçanti.

Gjithashtu, gjeneral Rama në këtë vizitë përfaqësuesit italianë i ka njoftuar me përparimin e FSK-së për realizimin e planit gjithëpërfshirës të tranzisionit, kapaciteteve aktuale dhe ngritjes së kapaciteteve mbrojtëse, duke theksuar nevojën dhe rëndësinë e mbështetjes nga pala italiane në këtë aspekt.

Me këtë rast ai ka theksuar objektivin strategjik për t'i ndërtuar forcat tona sipas

standardeve më të avancuara dhe të ndërveprueshme me forcat e vendeve të NATO-s, për të qenë kompatibile për operacione të përbashkëta paqeruajtëse.

Nga ana e autoriteteve italiane u vlerësuan lart të arriturat e deritashme të FSK-së si forcë profesionale në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës si dhe në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë. Në fund të dyja palët u pajtuan që bashkëpunimi në mes të dy forcave të thellohet dhe të shtohet edhe më tej në fushat me interes të përbashkët.

## ShSKUK-ja përfiton donacion në vlerë 100 mijë euro

**PRISHTINË, 19 MARS (ER)** - Është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe Organizatës Care for Kosovo Kids.

Qëllimi i këtij memorandumi është renovimi i Laboratorit të Patologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ku, përvetëz

renovimit, parashihet edhe blerja e pajisjeve të reja në vlerë 100 mijë euro.

Dr. Valbon Krasniqi, drejtor i ShSKUK-së, ka falënderuar donatorët, duke siguruar se donacionet e tillë do të shfrytëzohen në mënyrën më të mirë të mundshme për pacientët. Ndërsa dr. Sevim Cinci, përfaqësuese e autorizuar nga CFKK, ka pohuar se si organizatë kanë mbështetur

në vazhdimësi QKUK-në dhe në të ardhmen do ta mbështesin edhe me donacione të tjera, duke mos lënë anash as fëmijët me kancer.

Care for Kosova Kids në vazhdimësi ka dhuruar donacione për QKUK-në, duke përfshirë barnat dhe citostatikët për fëmijët në Repartin e Hemato-Onkologjisë në Klinikën e Pediatrisë.



# A të bën më të lumtur migrimi?



Nga Mimoza  
KELMENDI

20 marsi është Dita Botërore e Lumturisë. Sipas raportimeve vjetore nga OKB-ja, vendet ku njerëzit jetojnë më të lumtur janë: Finlanda, Norvegjia, Danimarka, Islanda, Zvicra. Gjermania ndodhet në vendin e 15 në listën e gjatë të 159 vendeve në botë që mbyll me vendet si: Tanzania, Jemeni dhe Sudani Jugor. Edhe migrantët ndjehen më të lumtur në Finlandë dhe në vendet e tjera skandinave se sa në Gjermani, Francë apo Itali. A është dikush i kënaqur me jetën e tij apo jo, kjo nuk mund të zgjidhet lehtë, thonë studiuesit e lumturisë. Në vendlindje apo gjetkë, edhe përkëtë ka përgjigje. E përgjithshmja është kur

plotësohen kushtet për një jetë të mirë. "Të kesh, të duash dhe të jesh", janë tre kushtet bazë për të qenë i lumtur shpjegojnë shkencëtarët. Por si mund të matet niveli i lumturisë? A ka një opinion publik global? Fakt është që qëndrimet e njerëzve në mbarë botën po afrohen gjithnjë e më shumë. Kjo mbështetet nga një sondazh i fundit në Gjermani. Pyjetes, se "cilit mendoni se janë gjërat më të rëndësishme në jetë", shumica e njerëzve i përgjigjet me "shëndeti" dhe "familja". Por a të bën më të lumtur migrimi?

Unë personalisht i takoj brezit që fatin e jetës e kërkon aty ku ndjehesh e lumtur, ndryshe nga kufijtë e ngushtë të vendlindjes. "E keqja e botës nuk ndalet në qytetin dhe farefisninë tonë", thotë një shkrimitar. Pra. bota e përsosur, amtare është një endërr. Ajo është një utopi. Në një nivel personal, ekzistencial, ajo gjithmonë e ka shoqëruar njerëzimin. Për disa, kjo endërr mund të jetë sjellëse fati. Për të tjerët, krijon presion. Në një mjeshtëri familjar, kjo endërr

shpesh shndërrohet në të vërtetë, por shumë shpesh kjo nuk është asgjë më shumë se një gjenjeshtë. Në fund të fundit, është një rastësi se ku ndeshesh me të keqen e botës: në qytetin të tundit ose në një të huaj. Për mua janë njerëzit që përbëjnë shtëpinë dhe vatrën time. Ata mund të jetojnë në vendlindjen time ose larg saj. Unë jam gjithmonë e lumtur kur i takoj atje ku jetojnë. Migrimi mund të jetë një masë profilaktike për shëndetin. Kjo varet nga motivet për të emigruar dhe rrëthanat në të cilat njerëzit imigrojnë. Për shumë njerëz migrimi është një hap që ndërmerr për të shpëtuar jetën, dhe kjo natyrish që i bënë ata të lumtur. Për shumicën jeta në Gjermani (meqë jetoj këtu) është megjithatë më e mirë se në vendet e origjinës. Njerëzit me prejardhje migracioni janë mjaft të kënaqur me jetën e tyre në Gjermani. Gjendja e tyre e të qenit të kënaqur nuk është thuajse aspak më e keqe krasuar me mesataren e popullsisë. Sipas një hulumtimi,

veçanërisht të kënaqur janë ata, që e zoterojnë mirë gjuhën gjermane. Madje ata janë zakonisht më të kënaqur se mesatarja. 49 për qind të migrantëve përvèç kësaj e konsiderojnë situatën e tyre ekonomike si të mirë apo shumë të mirë, ndërsa tek gjermanët janë vetëm 45 për qind që mendojnë kështu.

Brezi i parë, që ka emigruar, vjen zakonisht nga vende më të varfra, me kushte më të këqija jetese. Kur ata vinin në Gjermani e përjetonin se si iu përmirësohen standardi i jetesës. Kjo shprehet me një kënaqësi më të madhe ndaj jetës, pavarësish nga çështja se sa mirë ishin të integruar këta njerëz. Gjenerata e dyte, e cila ka lindur këtu nuk krasohet thuajse fare me kushtet e jetesës së vendlindjes së prindërvë të tyre. Ata fokusohen më shumë në pozicionin e tyre në shoqërinë gjermane. Dhe kjo është arsyja pse në hulumtime dalin shpesh rezultate befasuese në shikim të parë: gjenerata e dyte edhe pse e integruar më mirë, është më pak e kënaqur

me jetën në krasim me prindërit. Shumë të tjerë e lidhin me fatin e atdheut që kanë lënë pas. Ashtu sikurse 100 e ca vjet më parë i madhi Faik Konica do të shkruante: "Përgjegjësia jonë ndaj vendit është e pamohueshme: do vuajmë me vuajtjet e Shqipërisë, do gëzojmë me gëzimet e saj".

Shumë migrantë në Gjermani kanë një përparësi sa i përket të qenit të kënaqur dhe kjo nuk ka të bëjë më edukimin apo karrierën. Sidomos tek familjet nga Evropa Juglindore është familja dhe përkrahja familjare shumë e rëndësishëm. Kjo luan një rol të madh dhe pozitiv tek shumë migrantë, bëjnë të ditur studiuesit. Por sado mirë që mund të jetë realizuar një studim, ai nuk mund të shprehë asgjë se sa i lumtur është individi me jetën e tij. Në fund të fundit lumturia duhet kuptuar që nuk është një destinacion por një proces që nuk mbaron kurrë. Ajo është si një rrugë që nuk i dihet fundi, por duhet të shihjet ecja. Ndaj është mirë të zgjedhësh rrugën më të gjatë, sepse të shkurtrat zgjasin pak ose hiç.

## Rihapet rasti lidhur me vrasjen e Agonis Tetajt



**PEJË, 19 MARS** - Gjykata e Pejës të premten ka marrë vendim që ta rihapë shqyrtimin në çështjen e vrasjes së Agonis Tetajt. Ky rast ka marrë vëmendjen e opinionit publik pas publikimit të videos në momentin e vrasjes së të ndjerit Agonis Tetajt. Isuf Tetaj, babai i të ndjerit Agonis Tetajt,

përmes një e-maili ka alarmuar opinionin publik lidhur me dyshimet e tij se prokurori i cili përfaqëson akuzën në rastin për vrasjen e djalit të tij, Agonis Tetaj, prokurori Agron Uka ka bërë ricilësimin e veprës penale nga "vrasja e rëndë" në "vrasje nga pakujdesia". Letra e Isuf Tetaj

ishte drejtuar për mediat, shoqërinë civile, ambasadat e huaja në vend dhe bashkangjitur ka edhe videon e momentit të vrasjes së djalit të tij. Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka marrë lëndën e vrasjes së Tetajt nga prokurori Agron Uka për t'ia

ndarë dikujt tjetër si dhe ka kërkuar nga gjykata që rasti të rihapet. Këto dëshmi dolën në sipërfaqe pasi prokurori Uka kishte vendosur që në ditën e fundit të gjykimit ta ndryshonte veprën e të akuzuarit Gogaj nga vrasje e rëndë në vrasje nga pakujdesia. Kjo shkaktoi

reagime të mëdha, sidomos nga familja e të ndjerit, Agonis Tetajt, të cilët shpërndanë videojn nga kamerat e sigurisë që kishin kapur momentin e vrasjes së Agonis Tetajt. Përmes videos, familja pretendon se vrasja nuk ka qenë aksidentale siç pretendon prokurori.

# Transporti rrugor vazhdon grevën deri në realizimin e kërkeshave

Në shenjë proteste për mossubvencionimin nga Qeveria në detyrë e Kosovës, shumë kompani të autobusëve kanë protestuar të premten në Prishtinë. Kryetari i Shoqatës i Transportit Rrugor të Udhëtarëve, Ruzhdi Kurtishaj, ka thënë se protesta është alarm i fundit për qeverinë për realizimin e marrëveshjes të arritur në janar të këtij viti

**EPOKA ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 19 MARS** - Greva e Shoqatës e Transportit të Udhëtarëve do të vazhdojë derisa qeveria të fillojë zbatimin e marrëveshjes për subvencionim. Kompanitë e transportit rrugor në Kosovë kanë protestuar të premten rrugëve të Prishtinës për t'i shprehur pakënaqësitë e tyre lidhur me mossubvencionimin nga qeveria në detyrë.

Kryetari i Shoqatës i Transportit Rrugor të Udhëtarëve, Ruzhdi Kurtishaj, ka thënë se protesta është alarm i fundit për qeverinë për realizimin e marrëveshjes të arritur në janar të këtij viti. "Numri i autobusëve që kanë marrë pjesë në protestë ka qenë rreth 250. Ne kemi kërkuar që mos të ketë numër të madh të autobusëve në mënyrë që të mos bllokohet komunikacioni. Kjo protestë duhet të jetë alarmi i fundit për Qeverinë e Republikës

së Kosovës që të mblidhet urgjentisht dhe të marrë vendimin e duhur për pagesën apo për realizimin e marrëveshjes së nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Shoqatës së Transportit Rrugor në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës për t'u dalë në ndihmë operatorëve të këtij sektori, të cilët, padrejtësisht, për shkak të vendimeve të qeverisë, krijuan humbje të mëdha", ka thënë Kurtishaj. Ai ka treguar se nga marrëveshja e arritur me qeverinë bëhet fjalë për subvencionimin e 450 operatorëve me 6.5 milionë euro. Kurtishaj ka thënë se nëse nuk ka reflektim të qeverisë deri në fillim të javës së ardhshme. Protesta do të vazhdojë të hënën në orën 10:00 para qeverisë me një numër të caktuar të autobusëve.

Ndërkak qyshministri në detyrë, Avdullah Hoti, nëpërmjet një komunikate për media ka kërkuar nga Shoqata e Transportit Rrugor të Udhëtarëve që sa më parë të



kthejnë shërbime për qytetarët. Ai ka shprehur gatishmërinë për diskutim me përfaqësuesit e këtij sektori me qëllim të gjetjes së një zgjidhje të favorshme.

Në komunikatë thuhet edhe se

bizneset e sektorit të transportit të udhëtarëve kanë qenë përfitues nga masat e qeverisë (pagesa prej 290 eurove për numër të të punësuarve, pagesa 50 për qind të qirasë, pagesa e 170 eurove). Në

fund të komunikatës shpjegohet se pandemia Covid-19 ka prekur shumë sektorë dhe se është e pamundur që shteti të kompensojë çdo humbje që kanë pasur bizneset.

## Nitaj kërkon pezullimin e përzgjedhjes së kryeshefit të Postës

**EPOKA ERE** **A. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 19 MARS** - Ministri në detyrë i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Muhammed Nitaj, ka njoftuar përmes një shkresë zyrtare se ka vendosur pezullimin e përzgjedhjes së kryeshefit ekzekutiv të Postës së Kosovës, me arsyetimin se nuk është respektuar Ligjipër Ndërmarrjet Publike. "Në cilësinë e ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, e cila është aksionar në Ndërmarrjen Posta e Kosovës dhe me rekomandim të Njësisë

për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, kam kërkuar pezullimin e përzgjedhjes të kryeshefit ekzekutiv te Posta e Kosovës. Ndërsa arsyet kryesore të kërkesës për pezullim ka qenë fakti se nuk është respektuar nen 15.1 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ku thuhet se të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtoreve të Ndërmarrjeve Publike, zgjedhën në një mandat trevjeçar, ndërkohë që bordi ka marrë vendim që kryeshefi ekzekutiv, që njëkohësisht është anëtar i bordit të drejtoreve, të zgjidhej



në mandat pesëveçar", është thënë në deklaratën e Nitajt. Më tej theksohet se arsyet qyshministri tjetër është se qeveria në detyrë është në përfundim të mandatit të saj dhe është më se e arsyeshme që qeveria e re të procedojë emërimet e reja të drejtuesve të ndërmarrjeve publike. "Për më tepër, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit muaj më parë ka kërkuar në vazhdimi nga bordet e përkohshme, që të mos procedohet me rekrutimin dhe përzgjedhjen e zyrtarëve të lartë në ndërmarrjet publike", ka thënë ministri Nitaj.

## KEDS-i investon në zonën turistike të Brezovicës

**PRISHTINË, 19 MARS (ER)** - KEDS-i është duke përfunduar një projekt të madh investues në Brezovicë. Përmes këtij investimi do të rritet siguria e furnizimit dhe do të përmirësohet dukshëm kualiteti i shërbimeve. Sipas KEDS-it, kjo do të ndikojë drejtpërdrejt edhe në zhvillim

të mëtutjeshëm të asaj ane, e cila konsiderohet zonë turistike. "KEDS-i tashmë ka vendosur trafoblindën të re me kapacitete të mjaftueshme për t'i furnizuar konsumatorët e asaj ane dhe ka bërë shtrirjen e kabllave komplet të reja bashkë me stabilimente përcjellëse.

Investimet në rrjetin energjetik po vazhdojnë çdo ditë anekënd Kosovës. Kjo tregon përkushtimin e kompanisë për përmbrushjen e pretimeve dhe vendosmërinë për të ofruar shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe rrjet të sigurt", ka njoftuar KEDS.



Përsiatje politike / TRIADA E KOSOVËS (11)

# Implikimi i drejtpërdrejtë i shtetit shqiptar në ngjarjet e marsit



Shkruan: Bedri ISLAMI

Pas afishimit të qëndrimit të shtetit shqiptar, në Kosovë, pa mëdyshje, kemi dy tablo të ndryshme. Nga njëra anë është ndjenja e madhe e lehtësimit dhe e ripërtëritjes që përshkoi demonstruesit, sidomos të burgosurit politikë, ndërsa nga ana tjetër egërsia e mekanizmave shtetërore. I gjithë mekanizmi i stërmadh titist, në gjashtë republika dhe në dy krahina, u vu në lëvizje. Nuk duhet haruar se ky mekanizëm kishte, asokohe, mbështetje jo të paktë. Jugoslavia e pas Titos, ndonëse e çalë, ende kishte një vello, që kur do t'i hiqej plotësisht, do të dilte në pah gjakimi që ndodhi. Asnjë krijësë e sajtar shtetesh dhe e mbështetur aq verbërisht nuk do të kishte një fund aq të përgjakshëm sa Jugoslavia e Titos. "Plaku", si e quanin asaj kohe, kishte mbajtur vendin nën vete por, ndërkohë, nacionalizmat kishin imprehur thikat. Shqiptarët nuk do të duhej të bëheshin kurban i këtij gjakimi; në fillimin e gjithçkaje për to ishte e rëndësishme të dihej se, edhe në një moment pashmangshmërisht të vështirë të ardhshëm, do të kishin një mbështetje nga shteti shqiptar.

Është e qartë pse u sulën kundër Shqipërisë gjithfarë robërish sllavë, por më e çuditshme ishte se nuk mbetën pas tyre as çakejtë shqipfolës. Dushan Ristic thërriste se "kurrfarë librash nuk na duhen nga Shqipëria" dhe kjo është edhe faza, kur për të disatën herë ngrijnë marrëdhëni mes dy shteteve. Por njerëzit, besoj, nuk i kanë haruar edhe Kolë Shirokën, Xhavit Nimanin, Fadil Hoxhën, Veli Devën që, si tëpërmjerrur, bridhnin nëpër sallat famëzeza të diferencimit. Pikërisht në atë kohë filloi të merrte "hov" edhe një nga pinjollët më të paskrupullt të titizmit dhe të diferencimit, Azem Vllasi, karriera e të cilit, si rrallëherë, u ngrit mbi gjakun që ishte derdhur në pranverën e vitit 1981, dhe, po ashtu, si rrallëherë, edhe pas kaq vitesh, mbetet në të njëjtën pozitë mjerane dhe

diferencuese.

Deri në atë kohë, në shtypin e shtetit shqiptar, ishte bërë kujdes me emrat e politikanëve shqiptarë të Kosovës. Ata, ose nuk përmendeshin ose, përgjithësisht, përmendeshin pa asnjë kontekst, negativ apo pozitiv. Mendohej, në rrethe të ngushta gazetarësh, se kjo vjen nga një lloj nostalgjje e Enver Hoxhës, pasi ata ishin nisur nga vetë ai për të organizuar luftën në Kosovë dhe për të organizuar Konferencën e Bujanit. Nostalgji, që po ashtu nuk ishte edhe shumë e justifikueshme, nëse, njëkohësisht, merrje parasysh edhe të tjera ngjarje. Por, kur filloj debati i madh, kjo tabu u thye dhe, për herë të parë, u bë publike shprehja "një qen serb me emrin Sinan Hasani".

Për implikimin e drejtpërdrejtë të shtetit shqiptar në ngjarjet e marsit, edhe pas kaq vitesh, nuk është sjellë ndonjë provë konkrete. Por kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur implikim indirekt, përmes një mijë e një gjëra të tjera, si propaganda që bëhej posaçërisht për Kosovën, nëpërmjet radiostacioneve dhe TV Shqiptar, dërgimit të librave dhe kontakteve me njerëz të ndryshëm. Mirëpo, këto nuk përbëjnë fakt dhe nuk janë forcë madhore për të organizuar ngjarjet e pranverës së vitit 1981.

Muajt që kalonin, natyrisht duke mos i lënë asgjë spontanitetit, e bënë edhe më të qartë qëndrimin e shtetit shqiptar.

Më 23 prill, përsëri në "Zérin e Popullit" dhe përmes RTSH, u bë publik artikulli "Kush e nxit armiqësinë midis popujve të Jugosllavisë". Ishte një përshkallëzim i mëtejshëm i qëndrimit të shtetit shqiptar dhe përsëri, për këdo qe e qartë se, në mos në të gjithin, në thelbin e artikullit ishte dora e Enver Hoxhës.

Çfarë kishte të re në këtë qëndrim të afishuar për herë të dyte?

Le të shkëputim tre nga pasazhet më thelbësorë:

- Udhëheqësit jugosllavë, që nga më i madhi deri te më i vogli, pretendojnë se në vendin e tyre për të gjitha kombet dhe kombësítë ekziston "barazia në të drejta politike dhe ekonomike", ekziston "bashkim-vëllazërimi". Po si mund të besohen ata, kur një republikë apo një krahinë trajtohet si "djali i nënës" dhe krahina

tjetër si "i njerkës", kur një "vëlla" ha me lugë të artë, kurse tjetri me lugë të vogël prej druri? Kjo nuk tregon as "bashkim", as "vëllazërim".

- Dolanci, në intervistën që përmendëm, tha se në demonstratat në Kosovë u vranë 11 veta. Një shërbëtor i tij shqiptar nga udhëheqja e Kosovës tha nëntë. Me sa duket, s'patën kohë të merreshin vesh dhe të binin dakord. Megjithatë, të gjithë gjenyen opinionin botëror dhe atë jugosllav. Por këto më mirë i di vetë populli i Kosovës, pse gjaku i tij u derdh. Ai e di, gjithashtu, pse u derdh ky gjak dhe kush e bëri këtë gjëmë.

- Në rast se në demonstrata ishin pak njerëz, atëherë pse Beogradë dërgoi ushtrinë, milicinë e kryeqytetit, tanket dhe avionët? Përse u vranë dhe u plagosën me armë zjarri aq njerëz dhe përse u vendos shtetetësimi? Për një "grusht të vogël armiqsh", për 10-15 veta që u quajtën nga udhëheqja jugosllave "reakcionarë, shovinistë, irredentistë"?

Vallë për një kokërr limoni prishet dasma, ajo "dasmë", për të cilën tanë nga të katër anët e Jugosllavisë vërshojnë si ujët e Danubit, të Savës dhe të Dravës telegramet plot indinjatë e zemërim kundër "shovinistëve" dhe irredentistëve shqiptarë", dhe plot himne ditirambe për "unitetin e kombeve dhe të kombësive të Jugosllavisë"? Me të tilla truke nuk është e lehtë të gjenjehet një popull trim e i pjekur, siç është populli shqiptar që jeton në pjesë të ndryshme të Jugosllavisë, të gjenjehen punëtorët, fshatarët, studentët dhe inteligjencia e ndershme, të cilët janë të ndërgjegjshëm për jetën dhe fatin e kombit të tyre.

Kush e ndjell dhe e nxit, pra. armiqësinë në mes popujve të Jugosllavisë? Artikulli i natyrshëm, i drejtë dhe i matur i "Zérin të Popullit", apo kjo fushatë e tërbuar që ka ngritur udhëheqja e Jugosllavisë kundër popullsisë shqiptare të Kosovës?

Artikulli i 8 prillit 1981, që ishte edhe shfaqja e parë e qëndrimit politik dhe kombëtar i shtetit shqiptar, ishte pritur padyshim me një ankth të madh nga demonstruesit, dhe secila ditë që kalonte, e shtonte ankthin e pritjes së tyre. Demonstruesit e kishin të qartë dhe e kishin pritur se

nga shovinizmi serbomadh dhe pasuesit e tyre në Kosovë do të quhen, ashtu si u quajtën, "shovinistë, irredentistë, reaksionarë, shqiptaromëdhënëj, prishës të bashkim - vllaznimit" etj. etj. Heshtja disaditore e shtetit shqiptar i kishte futur ata në një dyshim tjetër: mos vallë kishin gabuar dhe nuk do e kishin këtë mbështetje, të cilën edhe e pritnin. Thyerja e heshtjes dhe qëndrimi i shtetit amë kishte sjellë qetësinë e pritur të shpirtit të tyre, por njëkohësisht, edhe arrogancën dhe thelbin nationalist serbomadh. Për shtetin jugosllav dhe sidomos atë serb, qëndrimi i shtetit shqiptar, ashtu si po ndodhë, dhe afishimi i gjendjes së vërtetë në Kosovë, ishin shkaku themelor i ngrirjes së marrëdhënieve dypalëshe, gjë që ishte llogaritur se mund të ndodhë edhe nga Shqipëria, dhe ishin marrë parasysh të gjitha pasojat e mundshme.

Megjithatë shteti shqiptar shkoi edhe më tej në afishimin e qëndrimit të tij. Ndoshja ishte pritur se, në mos një ditë, një ditë tjetër, mendjet e arsyeshme të politikës jugosllave, gjithmonë nëse do të kishte të tilla, do ta kuptonin të vërtetën se përmes gjakut dhe vrasjeve nuk mund të qetësohej gjendja në Kosovë. Kishte qenë një pritshmëri e kotë, ashtu si do të ishte edhe më vonë. Duke mos marrë përsipër rolin primar, strukturat e larta të shtetit, organizuan afishimin dhe mbështetjen e mendimit intelektual shqiptar, në të

gjitha organet dhe ne të gjitha strukturat e mundshme. Qëllimi i kësaj fushatë nuk ishte thjesht mbështetja e qëndresës që po ndodhë në Kosovë, por edhe dëshmimi historik, moral dhe kushtetues i së drejtës së shqiptarëve në Jugosllavi për të pasur republikën e tyre, si kërkesë themelore e demonstruesve. Është mëkat i madh dhe faj i jashtëzakonshëm historik, që klasa politike në Kosovë, me përjashtime të rralla, si Pajazit Nushi, Ymer Jaka, Ukshin Hoti, nuk u ngrit, të paktën në nivelin kombëtar të demonstruesve të thjeshtë. Ata u ktheyen në pinjollë, herë pas here të neveritshëm, të mbështetjetës së masave të jashtëzakonshme dhe dhunës policore që ushtronë Beogradë mbi popullin e tyre. Kjo ishte dhe vazhdon të mbetet njolla më e madhe politike e kësaj klase, e cila, j a s h t ë z a k o n i s h t paarsyeshëm, vazhdoi rrugën e diferençimit masiv mes popullit, krioi mitin e rremë të "demonstratave armiqësore", thirri në ndihmë ushtrinë dhe policinë serbe dhe lejoi, që, edhe një herë, të gjakosej populli i Kosovës. Mjerisht, në asnjë tubim publik, kjo klasë politike, nuk mbështeti haptas kërkesën për Republikën e Kosovës. Atëherë kjo detyrë, që ishte edhe imperativ i kohës, u mor përsipër nga shteti shqiptar, i cili afishoi hapur se, "Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e Republikës është e drejtë" ("Zëri i popullit", 17. 05. 1981) Vilon



Rallëherë ndodh qe lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjiejë thelli mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijuarë filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asnjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymber Kelmendi

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisitorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjalë të shqyrtuan ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

\*\*\*

Një libër që zërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhreve biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dha me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

\*\*\*


Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se "thjeshtësia është madhështi".

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



ISBN 978-9951-780-37-7  
9 789951 780377



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuar i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.


Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpuçë në Berlin* është novela e tij e parë.

4.99 €



ISBN 978-9951-780-10-0  
9 789951 780100



# **Short i pamëshirshëm, Bayern - PSG-së, Real - Liverpool**

Shorti i Ligës së Kampionëve ka qenë i pamëshirshëm, pasi ka sjellë dy finale të parakohshme në kuadër të çerekfinales. Bayern Munchen, që e mban trofeun e më të mirit, do të përballet me PSG-në, skuadër të cilën e mposhti në finalen e vitit të kaluar. “Finalja” e dytë do të jetë në mes të Real Madridit dhe Liverpoolit

**EPOKA  
E BE**

Veton ZYMBERI

**NION, 19 MARS** - Të premten në Nion të Zvicrës është hedhur shorti për çerekfinalet e Ligës së Kampionëve. Skuadrat që u përballen në edicionin e kaluar në finalen e madhe, Bayern Munchen dhe PSG-ja, do ta ndajnë mejdanin në këtë fazë të garës me të fortë në futboll.

gares me te lorfë ne futboll. Skuadra gjermane, që është edhe kampione në fuqi e Evropës, synon mbrojtjen e këtij trofeu. Në anën tjetër, francezët e PSG-së, të motivuar pas eliminimit që ia shkaktuan Barcelonës, besojnë se mund të hakmerren për disfatën që pësuan në finalen e kaluar. Një tjetër përballje e zjarrtë do të zhvillohet në mes të Real Madridit dhe Liverpoolit. Këto dy skuadra, pavarësisht prej potentialit të madh, këtë edicion nuk po arrijnë të tregojnë më të mirën në kampionatet përkatëse. Ndërsa skuadra

kryesuese në Premierë Ligë, Manchester City, do të përballet me Borussia Dortmund. Padyshim se priten dy ndeshje spektakulare për faktin se këto klube aplikojnë futboll ofensivë. Chelsea, e cila e eliminoi Atletico Madridin, duke regjistruar dy fitore, ka qenë skuadër me fat në hedhje të shortit, sepse përballë do ta ketë Porton.

Shorti ka përcaktuar edhe përballjet e gjysmëfinales. Fituesi i ndeshjes Bayern Munchen - PSG do të përballet me fituesin e Manchester City - Borussia Dortmund, kurse fituesi i ndeshjes Real Madrid - Liverpool përballet me fituesin e ndeshjes tjetër Porto - Chelsea. Ndeshet e para çerekfinale do të luhen më 6 dhe 7 prill, kurse të kthimit zhvillohen një javë më pas, më 13 dhe 14 prill. Brenda prillit luhen edhe gjysmëfinalet e para, më 27 dhe 28 prill, kurse të kthimit më 4 dhe 5 muaj. Finalja zhvillohet më 29 maj në stadiumin "Ataturk" në Stamboll.



## Unitedi dhe Arsenali me fat, Roma përballet me

Liga e Kampionëve

**Bayern Munchen - PSG**  
**Real Madrid - Liverpool**  
**Manchester City - Borussia Dortmund**  
**Porto - Chelsea**

Liga e Evropës

**Granada - Manchester United**  
**Arsenal - Slavia Prag**  
**Ajax - Roma**  
**Dinamo Zagreb - Villarreal**

Dy klubet angleze, Manchester Unitedi dhe Arsenali, kanë pasur fat në shortin e Ligës së Evropës, pasi kanë “peshkuar” kundërshtarë të lehtë. “Djatjtë e Kuq”, pas eliminimit të Milanit në 1/8-at, tash do të përballen me Granadan dhe synim e kanë ta mposhtin këtë skuadër dhe të kualifikohen fillimisht në gjysmëfinale e më pas në finalen e madhe të garës së dytë.

**Liga e Kampionëve**

**Bayern Munchen - PSG**  
**Real Madrid - Liverpool**  
**Manchester City - Borussia Dortmund**  
**Porto - Chelsea**

**Liga e Evropës**

**Granada - Manchester United**  
**Arsenal - Slavia Prages**  
**Ajax - Roma**  
**Dinamo Zagreb - Villarreal**

Pargue. Skuadra e Granit Xhakës është favoritja e dytë në këtë garë dhe është favorite absolute ndaj çekeve. Ndërkokë, Villareali do të ketë punë me befasinë më të madhe të kësaj gare, Dinamon e Zagrebit. Përballje interesante do të zhvillohet në mes të Ajaxit dhe Romës. Ndeshjet e para këtij raundi do të luhen më 8 prill, ndërsa ato të kthimit një javë më pas, ndërkokë që finalja e madhe e sezonit 2020-2021 e Ligës së Evropës do të zhvillohet më 26 maj në stadiumin Miejski në Gdansk të Polonisë.

# Superliga vjen me përballje interesante



**PRISHTINË, 19 MARS** - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 25-të në FIVE STAR Superligë e Kosovës në basketboll. Takimi i parë do të zhvillohet ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Sigal Prishtinës, një duel shumë interesant. Këto dy skuadra u takuan edhe në finale të Kupës, ku triumfuan prishtinasit. Por, në elitën e basketbollit therandasit ndodhen në pozitën e dytë, kurse bardhekaltrit në vendin e shtatë. Ylli ka grumbulluar 39 pikë, gjashtë më shumë se Prishtina. Dueli tjetër i së shtunës është në mes të Bashkimit dhe Peiës, dy skuadra

me traditë në basketbollin e Kosovës, por që nuk arritum rezultate të dëshirueshme në stinorin pranveror. Prizrenasit ndodhen në vendin e pestë me 35, me një pikë më pak pejanët. Lideri Ponte Prizreni do të sfidohet nga Rahoveci. Prizrenasit kanë grumbulluar 41 pikë, kurse Vreshtarët kanë dy pikë më pak, andaj pritet një duel shumë interesant. Përballja e fundit, por shumë e rëndësishme është në mes Trepçës dhe Vëllaznimit. Mitrovicasit hyn në këtë duel pas fitores ndaj Yllit, kurse kugezinitë në duelin e fundit

pësuan nga Bashkimi.  
'Xehetarët' kanë grumbulluar  
34 pikë dhe kanë treguar formë  
të lartë, sidomos në stinorin  
pranveror, ndërsa skuadra nga  
Gjakova renditet në vendin e  
fundit me 31.

**FIVE STAR Superliga - Jornada 25**

**Të shtunën takohen:**  
**17:00 Golden Eagle Ylli - Sigal Prishtina**  
**19:00 Boshkimi - Peja**

**Të dielën takohen:**  
**17:00 Ponte Prizreni - Rahoveci**  
**19:00 Trepca - Vëllaznimi**

## Shtyhet ndeshja Prishtina - Gjilani

**PRISHTINË, 19 MARS** - Ndesha derbi e javës së 26-të në Superligën e Kosovës në futboll në mes të Prishtinës dhe Gjilanit është shtyrë. Arseja e shtyries është që të ruhet

fusha në stadiumin "Fadil Vokrri" për ndeshjet e Përfaqësueses së Kosovës. "Për shkak ruajtjes së fushës së stadiumit 'Fadil Vokrri', për ndeshjet e Kosovës, ndeshja e javës së 26-të

ndërmjet Prishtinës dhe Gjilanit  
është shtyrë për ditën e martë, më 30  
mars. Dueli fillon nga ora 15:00",  
thuhet në njoftimin e klubit  
kryeqytetas.



## 'Labi' ndihmon FC Ferizaj me 3 000 euro

**FERIZAJ, 19 MARS** - Skuadra që bën gara në Ligën e Parë, Ferizaj, është në një gjendje të rëndë ekonomike dhe si pasojë e kësaj ka bojkotuar stërvitjet dhe ka paralajmëruar edhe tërheqjen nga garat. Ish-

deputeti i Kuvendit të Kosovës dhe këngëtar i njohur Labinot Tahiri e ka ndihmuar këtë klub me 3 000 euro. "3 000 euro për klubin e futbollit të Ferizajt. Sa për lehtësimin e lojërave në vazhdimësi, i ndajmë këto

mjete 3 000 euro bujarisht e shpirtnisht, për të ngjallur jo vetëm Ferizajn, por të gjitha klubet sportiste në vendin tonë me qellim që të triumfojë sporti në arenën ndërkombëtare pa pengesa politike, e sidomos të rinjtë e

këtij atdheu të sjellin medalje për vendin, njëkohësisht edhe ta bëjnë jetën si Messi në Argjentinë e Ronaldo në Portugal. Ngjalluni, se kultura dhe sporti mbajnë shtetin në këmbë", ka thënë Tahiri.



## Lakersat arrijnë fitoren e katërt radhazi, shkëlqen LeBron

**LOS ANGELOS, 19 MARS** - Vijon momenti i artë për Los Angeles Lakersin në NBA. Kalifornianët regjistruan fitoren e katërt radhazi pasi imposhtën në "Staples Center" me shumë lehtësi Charlotte Hornets me rezultatin 116-105. Kampionët në fuqi të NBA-s e zgjidhën ndeshjen që në pjesën e parë pasi në fund të dy periodave të para kryesonin me 15 pikë epërsi. Diferencën në këtë sfidë e bëri mbreti James, me LeBron që koleksionoi në total 37 pikë, 8 rebounde dhe 6 asistime. Në mungesë të Anthony Davis dhe Marc Gasol, një dorë Lakersave në këtë sukses ua dha edhe gjermani Denis Schröder, autor i 24 pikëve. Kjo ishte fitorja e 28 në 41 takime për LeBron Jamesin me shokë, me skuadrën e Frank Vogel që parakaloj në renditje Phoenix Suns duke marrë vendin e dytë në Perëndim. Në një formë të shkëlqyer është edhe Atlanta Hawksi. Skuadra nga Georgia regjistroi fitoren e shtatë rresht pasi imposhti pa shumë



vështirësi Oklahoma City Thunderin me rezultatin 116-93. Dy më të mirët mbi parket për Atlantën ishin Trae Young dhe Bojan Bogdanoviç të cilët realizuan nga 23 pikë secili. Washington Wizardsi në mënyrë surprizuese i dha fund krizës prej pesë humbjes rresht duke imposhtur kryesuesit e Konferencës së Perëndimit, Utah Jazz. Në kryeqytet, falë edhe paraqitjes së shkëlqyer të dyshes Bradley Beal-Russell Westbrook, Wizards triumfoi me rezultatin 131-122. Bradley Beal shënoi 43 pikë, 1 më shumë se Mitchel i Utah, duke rezultuar pikëshënesi më i mirë i ndeshjes, ndërkohë që ishte thjesht magjik Russell Westbrook me një tjetër triple-double. Ylli i Washingtonit koleksionoi në total 35 pikë, 13 rikuperime poshtë tabelës dhe 15 pasime deçizive. Buzëqeshi edhe Portland Trail Blazersi që për meritë edhe të Damian Lillardit, autor i 36 pikëve, imposhti në "Moda Center" në Oregon New Orleans Pelicansin me rezultatin 101-93.

## Zvicra fton tre futbollistë shqiptarë, Belgjika rikthen Januzajn

**CYRIH, 19 MARS (ER)** - Kombëtarja e Zvicrës ka bërë publikimin e listës së lojtarëve për ndeshjet e marsit. Zvicra do të luajë kundër Bullgarisë dhe Lituanisë për ndeshjet kualifikuese në "Botërorin e Katarit 2022". Ndesha e parë do të zhvillohet më 25 mars, ndërsa tri ditë më vonë do të luhet edhe ndeshja me Lituaninë. Në këtë listë janë tre emra shqiptarë: Granit Xhaka, Admir Mehmedi dhe Xherdan Shaqiri. Përveç ndeshjeve kualifikuese, më 31 mars Zvicra do të luajë edhe një miqësore ndaj Finlandës. Edhe Kombëtarja e Belgjikës e ka publikuar listën e



lojtarëve për ndeshjet e marsit. Trajneri Martinez e ka rikthyer shqiptarin Adnan Januzaj, i cili ka pasur një sezoni të mirë me skuadrën e Real Sociedadit.

Belgjika më 24 mars do të luajë ndaj Uellsit për ndeshjet kualifikuese të Botërorit, ndërsa më 27 mars ndaj Çekisë dhe më 30 mars me Bjellorusinë.

## Rivaldo, Realit: Ronaldo nuk është ai që u largua

Fitusi i "Topit të Artë" më 1999, Rivaldo, ka folur për kthimin e mundshëm të Cristiano Ronaldos. Ditët e fundit janë rritur shumë këto spekulime, por ishi i Barcelonës dhe Brazilit nuk mendon që është diçka e mirë për të dyja palët, si për Realin, ashtu edhe për vetë Cristiano Ronaldon. "Duhet të pranojmë që CR7 që u largua nga Real Madridi disa vjet më

parë dhe nuk është i njëjtë me atë tanë. Sigurisht ai do të vazhdojë të shënojë shumë gola dhe të bëjë dallimin, duke treguar vendosmërinë e tij të jashtëzakonshme në fushë, por kjo mund të ishte diçka e tepërt në këtë fazë të karrierës. Nëse gjërat nuk do të shkonin mirë, statusi i tij si idhull mund të dëmtohet", ka dekluar Rivaldo. "Tani që me Laporten janë rritur

opsionet që Leo të qëndrojë, do të ishte fantastike të ribashkohen Messi dhe Cristiano në La Liga për disa vjet më shumë. Së pari, sepse do të ishte emocionuese jo vetëm për klubet e tyre, por për të gjithë dhe tifozët. Përveç kësaj, Spanja mund të kthejë pak madhështinë e saj, para Premierligës, Bundesligës ose Serisë A", ka shtuar Rivaldo.

## SHKURT

### Futsall / Kosova publikon listën përmiqësoret me Holandën

Përgjedhesi i Përfaqësueses së Kosovës në futsall, Arben Simitçi, e ka publikuar listën e lojtarëve përmiqësoret e muajit prill kundër Holandës. Këto ndeshje do të zhvillohen më 5 dhe 6 prill në Zeist. "Dardanët" e futsallit do të grumbullohen më 1 prill, derisa më 3 prill nisen për në Holandë. Lista e lojërave: Alfred Preniqi, Arbnor Krasniqi, Ramadan Alaj, Jeton Rukovci, Melos Kelmendi, Mërgim Dervishaj, Drilon Maxharaj, Durim Qorri, Getart Hyseni, Bardh Kelmendi, Fatlum Pishtani, Ylli Mazreku, Driton Nishori, Dijar Deliu.

### Ibrahimoviç: Nuk e meritonim eliminimin

AC Milani u eliminua nga Liga e Evropës dhe tani duhet të fokusohet në kampionat. Zlatan Ibrahimoviç analizoi humbjen 0-1 kundër Manchester Unitedit, karikon shokët e skuadrës dhe e mbyll me një batutë për Paul Pogba. "Jemi shumë të zhgënjyer, është normale. Na mungoi vetëm goli, teksha Unitedi shënoi në rastin e parë që krijoi. Nuk e meritonim eliminimin, por momentet negative të ndihmojnë përrit. Duhet të shohim përpëra, kampionati nuk ka përfunduar ende. Unë dua të luaj për të fituar. Nëse kualifikohemi në Ligën e Kampionëve bukur, por unë dua të fitojë trofe. Ne besojmë shumë të cilësitë tona, djemtë kanë shpirt sakrifice. Sigurisht se unë i kam sjell ekspit mentalitetin e fituesit. Nuk pranoj humbje në stërvitje, aq më pak në ndeshje", ka thënë Ibrahimoviç.

### Mourinho rrezikon shkarkimin

Jose Mourinho për një pjesë të mirë të tifozëve kudo në botë mbetet një trajner unik, por rikthimi i tij në Premierë Ligë ishte shumë larg emrit që përfaqëson. Tottenham pësoi një eliminim të turpshëm në Ligën e Evropës duke bërë që bankina e portugezit të vihet ndjeshëm në dyshim. As Mourinho nuk mund të jetë më i paprekshëm pas këtij eliminimi me përbysje nga Dinamo Zagreb. Në Angli flasin për një largim të sigurt të "Special One", jo më në fund të sezoni siç parashikohej, por shkarkimi i tij mund të vijë edhe më herët. Stafi drejtues i "gjelave" po mendon për pasuesin e tij dhe emri i parë në listën e dëshirave është një tjetër ishzikaltër, Luciano Spalletti.

### Alonso: I privilegjuar që garoj në Formula 1

Formula 1 mirëpret këtë sezon pas dy vjetësh mungesë dy herë kampionin e botës, spanjollin Fernando Alonso. Ai do të garojë me makinën franceze Alpine (ish-Renault), me shpresën që të jetë sërisht protagonist. "E konsideroj veten të privilegjuar që jam sërisht në pistë. Njoh mjaft pilotë të rinj dhe të talentuar që nuk kanë mundësi të provojnë një makinë të Formula 1 në karrierën e tyre", ka thënë Alonso. "Jam me fat që vendosa të ndërroj skuadër në momentin e duhur, të marr disa pushime në momentin e duhur dhe tani jam rikthyer. Gjithnjë kam pasur mundësi ta zgjedh fatin tim, ndaj jam sot këtu përrit", ka shtuar spanjollin. Duke folur për sezonin 2021, Alonso ka shtuar: "Lewis Hamiltoni është favorit edhe këtë vit. Ka dominuar këtë sport vitet e fundit, është i jashtëzakonshëm dhe nuk ka treguar shenja dobësie. Edhe pse rregullat ndryshojnë pak këtë vit, Mercedesi ka makinën më të mirë. Natyrisht se në Formula 1 nuk ka asnjë sigurt, pasi duhet fillimisht ta kalosh vijën e finish përrit. Të shohim se si do të ecin gjërat. Aksidenti me bicikletë? Do të vazhdoj ta përdor, ndoshta më larg rrugeve ku kalojnë makinat", ka përfunduar Alonso.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “DISTRICT” SH.P.K. ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 810120072 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “DISTRICT” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 810120072, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “DISTRICT” L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 810120072, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



NDËRMARRJA HİDROEKONOMIKE „IBËR - LEPENC“ SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE „IBËR - LEPENC“ J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE „IBËR - LEPENC“ D.D.

Sheshi “Bil Clinton” Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar “Bil Clinton” Br.13 Priština, Kosovo  
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: [info@iber-lepenc.org](mailto:info@iber-lepenc.org)

Ndërmarrja Hidroekonomike “Iber-Lepenc” SH.A. Prishtinë, Publikon këtë:

## N J O F T I M

1. Anulohet pozita në Konkursin e shpallur me datën 12.01.2020, në gazeten „Epoka e Re”, me të cilin është kërkuar:Punëtor në mirëmbajtjen e rrjetit të sistemit të ujites në Nj. Punuese “Vushtrri” (5)

2. I falenderojmë të gjithë pjesëmarrësit në Konkurs.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shqiptari Aksionare  
Trepça Deoniçarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënien me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 datë 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 19.03.2021 bënë shpallje publike për dhënien e pronës së paluajtshme mc qira.

### Shpallje Publike

T-21-002

Qëllimi i ofertës:	Dhënie me qira e fushës se futbollit me objekte përcjellës -Kishnicë
Kriteret e Dhënies:	Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë
Periudha:	3(tre) vite me mundësi vazhdimi
Data e shpalljes:	19.03.2021
Sqarimi:	deri me 26.03.2021
Kërkesa për pjesëmarrje:	Data(t) për kërkesës deri: 26.03.2021 Behet e e-Mail: poshtë shënuar.
Periudha vlefshmërisë ofertës:	30 ditë
Dorëzimi i ofertave:	Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizik (zarf te myllur) (Originali dhe Kopja)
Afati i fundit i dorëzimit:	05.04.2021 në 12:00
Vendi i dorëzimit:	Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë

### AUTORITETIT KONTRAKTUËS (AK)

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku inustrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: <a href="mailto:sales@trepcacorporation.com">sales@trepcacorporation.com</a>		Faksi: +383 (0) 28 539 202
<a href="http://www.trepcacorporation.com">www.trepcacorporation.com</a>		

**RESTAURANT**

---



**SWISS**

---

**TAVERNA**

---



## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Sale Elezovic shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Planjane " Planjane.
  - Fikri Hoxhaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
  - Fahro Veliji shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Planjane " Planjane.
  - Fahro Veliji shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
  - Vlora Milazim Imeri shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë me nr. 31, Bachelor i Gjeologjisë.
  - Jap banesë me qira afër 60 m<sup>2</sup>, katë III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
  - Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m<sup>2</sup>, me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
  - Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
  - Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m<sup>2</sup> dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
  - Lëshoj banës me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
  - Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përbal "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m<sup>2</sup>, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
  - Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
  - Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
  - Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
  - Lëshoj lokalë më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
  - Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
  - Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
  - Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
  - Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
  - Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplekt, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
  - Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
  - Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
  - Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m<sup>2</sup>. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
  - Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m<sup>2</sup>, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
  - Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
  - Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
  - Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplekt. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
  - Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i l-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.



ROYAL CROWN  
**RC** cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC** cola  
Columbus, Georgia, USA Since 1905 0.5L